Në bazë të iniciativës qytetare, në qytetin e Elbasanit ngrihen dhe funksionojnë 30 struktura komunitare si njësi të vetëqeverisjes komunitare. Si rregull, ngrihet dhe funksionon një strukturë në një territor me 4.000 - 7.000 banorë. Emërtimi dhe shtrirja territoriale e çdo strukture komunitare është sipas listës nr. 1, që është pjesë përbërëse e kësaj rregullore.

Neni 7

Regjistrimi i strukturave komunitare

Bashkia krijon dhe administron regjistrin e strukturave komunitare në qytet. Elemente që duhet të përmbajë regjistri janë: Emri i strukturës komunitare; emri ***dhe adresa e ndërlidhësit dhe e anëtarëve të këshillit*** komunitar; përshkrimi i shtrirjes territoriale dhe harta përkatëse. Një kopje e statutit të strukturave komunitare si dhe një kopje e vendimit për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit komunitar dhe të ndërlidhësit depozitohet në bashki për regjistrim në regjistrin e strukturave komunitare në qytet.

Neni 8

Organet e strukturave komunitare

Struktura komunitare drejtohet nga këshilli dhe ndërlidhësi komunitar. Numri i anëtarëve të këshillit komunitar varion nga 5 - 7 anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve, për çdo strukturë komunitare në qytet, përcaktohet nga banorët në kuvendin qytetar. Përbërja e këshillit komunitar duhet të përfaqësojë shtrirjen përkatëse territoriale, ku grupet e ndryshme komunitare gjenden të mirëpërfaqësuar.

Anëtarët e këshillit komunitar zgjidhen nga qytetarët, me pëlqimin e shumicës së njerëzve. Ndërlidhësi zgjidhet nga rradhët e anëtarëve të këshillit. Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar zgjidhen për një periudhë katër vjeçare.

Në çdo lagje krijohet bordi komunitar dhe në Bashkinë Elbasan krijohet asambleja komunitare. Bordi dhe asambleja përbëhen nga ndërlidhësat komunitar.

Neni 9

Periudha zgjedhore

Zgjedhja e strukturës komunitare në qytet bëhet një herë në katër vjet. Zgjedhjet fillojnë pesë muaj pas konstituimit të Këshillit të Bashkisë dhe përfundojnë brenda dy muajve. Data e zgjedhjeve, për këshillin komunitar, caktohet me vendim të Këshillit të Bashkisë 30 ditë para datës së mbajtjes së tyre.

Neni 10

Komisioni për strukturat komunitare

Për lehtësimin dhe monitorimin e procesit parazgjedhor dhe atë zgjedhor, me vendim të Këshillit të Bashkisë, krijohet komisioni për strukturat komunitare në qytet. Komisioni për strukturat komunitare në qytet përbëhet nga 7 anëtarë (tre përfaqësues të Këshillit të Bashkisë, tre përfaqësues nga shoqëria civile dhe një administratori i lagjes përkatëse). Ky komision aprovon statutin e strukturave komunitare në qytet.

Neni 11

Informimi i publikut

Komisioni për strukturat komunitare në qytet dy javë (14 ditë) para datës së mbajtjes së kuvendit qytetar, për zgjedhjen e këshillit, informon qytetarët, organizatat dhe rrjetet e shoqërisë civile, grupet e interesit, forumet intelektuale, rinore e qytetare etj., për datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së kuvendit qytetar.

Informimi i qytetarëve bëhet përmes: (i) medias së shkruar dhe vizive (ii) shpalljeve publike të vendosura në objekte publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit të strukturës komunitare (iii) web - faqes zyrtare të bashkisë (iv) njoftimeve në rrjetet sociale (v) takimeve informuese me qytetarët, etj.

Neni 12

Kandidatët për anëtar të këshillit komunitar

Kandidatët për anëtar të këshillit komunitar duhet të jenë qytetarët me vendbanim në territorin e strukturës komunitare, të cilët duhet të kandidojnë si qytetarë e jo në emër të ndonjë partie politike.

Kandidati duhet të plotësoj kushtet si më poshtë:

- a. Të jetë me vendbanim në territorin e strukturës komunitare;
- b. Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;
- c. Të mos jetë anëtar në Këshillin Bashkiak, administrator i njësisë administrative dhe në funksione drejtuese në administratën e Bashkisë;
- d. Të demostrojë gadishmëri dhe angazhim për të njohur, ndjekur dhe për të zgjidhur problemet e komunitetit;
- e. Të gëzojë reputacion të mirë në mesin e anëtarëve të komunitetit.

Neni 13

Letra e angazhimit civil

Çdo kandidat i vetëpropozuar apo i mbështetur nga grupe qytetare i paraqet kuvendit qytetar letrën e angazhimit civil. Letra e angazhimit duhet të përmbajë informacion rreth kandidatit për anëtar të këshillit komunitar si: emër dhe mbiemër; datën e lindjes; profesionin; numrin e letërnjoftimit dhe vendbanimin; motivet e kandidimit dhe angazhimit si dhe idetë për organizimin komunitar.

Neni 14

Kuvendi qytetar dhe keshilli komunitar

Në datën, orën dhe vendin e caktuar mbledhet kuvendi qytetar për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit komunitar.

Të drejtën për të marrë pjesë, me të drejtë vote e zgjedhje në kuvendin qytetar, e ka çdo banor me vendbanim në territorin e strukturës komunitare në qytet dhe që ka mbushur moshën 18 vjeç.

Mbledhjen e drejton përfaqësuesi i shoqërisë civile në komisionin zgjedhor dhe ndihmohet nga dy më të moshuarit e të dy gjinive pjesëmarrëse në kuvendin qytetar.

Kuvendi qytetar:

- a) Zgjedh sekretarin për mbajtjen e procesverbalit të kuvendit;
- b) Vendos për numrin e anëtarëve të këshillit;
- c) Miraton ndryshimet në statutin e strukturës komunitare;
- d) Dëgjon kandidatët për anëtar këshilli;
- e) Zgjedh anëtarët e këshillit komunitar.

Keshilli komunitar:

Keshilltaret propozohen ne mbledhjen e kuvendit qytetar dhe duhet te perfaqsojne te gjithë pjeset e territorit te lagjes dhe pas propozimeve kalohet ne proces votimi sipas nr. qe percakton kuvendi qytetar menyren e votimit e percakton kuvendi qytetar.

Anetar i keshillit zgjidhet ai qe merr shumicen e votave te pranishen ne mbledhje.

Perfundimi i mandatit te keshilltarit komunitar perfundon:

- a) Jep doreheqjen
- b) Kur humbet jeten
- c) Nuk eshte banor i perhershëm i lagjes.
- d) Shkarkohet nga kuvendi qytetar kur nuk kryen detyren dhe ben shkelje ligjore.
- e) Humbet zotesine juridike me vendim gjykate te formes prere.

Anetari i keshillit komunitar ne rastet e doreheqjes e dopoziton kerkesen tek kuvendi qytetar dhe administratori i lagjes dhe ne mbledhjen e radhes zhvillohet procedura e zgjedhjes te nje anetari tjetër.

Neni 15

Zgjedhja e ndërlidhësit komunitar

Komisioni për strukturat komunitare në qytet, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e përfundimit të kuvendit qytetar, organizon mbledhjen e parë të këshillit komunitar. Mbledhja e parë, deri në zgjedhjen e ndërlidhësit komunitar, drejtohet nga përfaqësuesi i shoqërisë civile në komisionin për strukturat komunitare në qytet dhe në mungesë të tij nga këshilltari më i vjetër. Mbledhja e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij.

Çdo anëtar këshilli, vetë apo nëpërmjet një grupi këshilltarësh, ka të drejtë të propozohet për ndërlidhës komunitar. Jo më pak se dy kandidatë duhet të propozohen për ndërlidhës.

Çdo kandidat për ndërlidhës komunitar duhet t'i paraqesë këshillit komunitar letrën e angazhimit të tij për këtë sipërmarrje.

Për realizimin e procesit zgjedhor, këshilli ngre komisionin e votimit me tre anëtarë. Votimi për ndërlidhësit komunitar bëhet kurdoherë i fshehtë.

Fitues shpallet kandidati që ka fituar shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit. Kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast, fitues shpallet kandidati që ka numrin më madh të votave dhe, nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short.

Mbledhjet e këshillit pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 16

Shkarkimi i ndërlidhësit komunitar

Propozimi për shkarkimin e ndërlidhësit bëhet me shkrim nga të paktën një e treta e anëtarëve të këshillit. Ndërlidhësi shkarkohet kur, me votim të fshehtë, votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit. Brenda 10 ditëve nga dita e shkarkimit të ndërlidhësit komunitar, organizohen zgjedhjet për ndërlidhësin e ri, sipas procedurave të nenit 15 të kësaj rregulloreje dhe mandati vazhdon deri ne perfundimin e periudhes mbetur te afatit kater vjecar

Nderlidhesi komunitar ne cdo rast qe largohet nga detyra duhet te dorezoje dokumentacionin dhe vulen tek administratori i lagjes.

Mandati i nderlidhesit komunitar perfundon para afatit ne keto raste:

- a) Jep doreheqjen
- b) kur humbet jeten
- c) Humbet zotesine juridike me vendim gjykate te formes prere.
- d) Nuk kryen detyrat e ngarkuara me ligj dhe ben shkelje ligjore.

Neni 17

Administrimi i dokumentacionit

Me përfundimin e kuvendit qytetar dhe të procedurave zgjedhore, komisioni për strukturat komunitare në qytet grumbullon dhe administron:

- a) Proçesverbalin e mbajtur nga sekretaria;
- b) Vendimin e kuvendit për formën, rregullat dhe procedurat e votimit;
- c) Proçesverbalin e rezultateve të votimit;
- d) Çdo ankesë që mund të kenë për proçesin.

Komisioni për strukturat komunitare në qytet, brenda dy ditëve, dorëzon në arkivin e Bashkisë dokumentacionin e sipërcituar.

Neni 18

Ankesa

Brenda tre ditëve nga dita e zhvillimit të kuvendit, çdo qytetar dhe kandidat për anëtar këshilli ka të drejtë të ankohet në bashki për shkeljen e të drejtave të tij gjatë proçesit të zgjedhjeve të strukturave komunitare në qytet. Ankesa depozitohet në sektorin e protokoll - arkivës të Bashkisë dhe i drejtohet komisionit për strukturat komunitare në qytet.

Komisioni për strukturat komunitare në qytet, brenda 7 ditëve, duhet të shqyrtoj dhe të marrë vendim për ankesën. Vendimi i komisionit është përfundimtar.

KREU III

KOMPETENCAT, FUNKSIONET DHE DETYRAT

Neni 19

Kuvendi i qytetarëve

Kuvendi i qytetarëve është një nga format e realizimit të demokracisë së drejtpërdrejtë. Qytetarët mbliidhen në kuvende qytetare dhe ushtrojnë të drejtën për:

- a) Të miratuar statutin e strukturave komunitare në qytet;
- b) Të zgjedhur apo dhënë pëlqimin për këshillin komunitar;
- c) Të vendosur për ngritjen, themelimin, bashkimin apo ndarjen e strukturave komunitare në qytet;
- d) Të vendosur masën, nivelin dhe qëllimin e vetëkontributit qytetar;
- e) Të vendosur rregulla dhe norma në përputhje me ligjin dhe aktet e bashkisë për ruajtjen dhe përdorimin e resurseve të përbashkëta, për harmoninë sociale, lehtësimin dhe mbështetjen e zbatimit të ligjit, standardet minimale të shërbimeve komunitare si dhe për transparencën në komunitet.

Neni 20

Këshilli komunitar

Këshilli Komunitar mbliidhet periodikisht sipas përcaktimeve që bënë vetë ai. Mbledhja e këshillit thirret nga ndërlidhësi komunitar ose 1/3 e anëtarëve të këshillit. Mbledhja e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij. Statuti i strukturave komunitare në qytet rregullon fushën e veprimtarisë, mënyrën e organizimit e të funksionimit si dhe të vendimmarrjes së ndërlidhësit e të këshillit komunitar. Në mënyrë të përgjithshme këshilli komunitar ndihmon dhe mbështet ndërlidhësin komunitar për të përmbushur misionin dhe funksionet e përcaktuara më sipër.

Neni 21

Detyrat e nderlidhesis komunitar

1. Nderlidhesi komunitar dhe keshilli komunitar i lagjes kryejne dhe mbeshtesin funksionet vete qeverisese te bashkise ne lagjen e tyre, si dhe kujdesen per zhvillimin ekonomik vendor, perdorimin e burimeve te perbashketa dhe sigurimin e harmonise sociale.
2. Bazuar ne vendimin e kryetarit te bashkise nderlidhesi komunitar dhe keshilli kryen edhe keto detyra:
 - a) Kujdeset per parandalimin e nderhyrjeve te paligjshme dhe te cdo lloj demtimi te rrugeve, trotuareve, ndricimit, lulishteve e shesheve publike ne lagje.
 - b) Kujdeset per ruajtjen e pyjeve kullotave si dhe te burimeve natyrore.
 - c) Kujdeset per ruajtjen e ambientit, grumbullimin edhe largimin e mbeturinave.
 - d) Kujdeset per furnizimin me uje te pijshem dhe energji elektrike ne lagje.
3. Kontrollon dhe njofton organet e bashkise dhe policise per kultivimin e bimeve narkotike ne lagje.
4. Merr pjese ne grupet e punes per verifikime te ndryshme ne lagje.
5. Ben njoftime te ndryshme per banoret e lagjes per probleme pune:
 - a) Njofton banoret per mobilizime te ndryshme per rastet e emergjencave civile si fatkeqesi natyrore per ndihme dhe kontribuon per evakuime te ndryshme sipas rasteve.
 - b) Ndhmon ne shperndarjen e njoftimeve tatimore per taksa e trifa familjare ne lagje.
 - c) Njofton banoret e lagjes per mbledhje te lagjes etj.
 - d) Njofton banoret per aktivitete te ndryshme ne lagje.
 - e) Njofton banoret per pune te ndryshme ne komunitet.
- 6) Nderlidhesi komunitar jep mendime per prioritete e investimeve dhe sherbimeve ne lagje.
- 7) Kujdeset per mbarevajtjen e arsimit dhe shendetsise ne lagje.
- 8) Kujdeset per ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore e historike ne lagje si monumente te kultures, natyres dhe veprave te artit.
- 9) Kujdeset per organizimin e vepritarive te ndryshme sportive, kulturore, artistike etj ne lagje.
- 10) Ben vendosjen dhe afishimin per publikim prane qendrave te votimit ne lagje te listave perfundimtare te votimit.
- 11) Bashkepunon me shoqata te ndryshme qe operojne ne lagje.
- 12) Bashkepunon ne shperndarjen e ndihmeve te ndryshme humanitare ne raste fatkeqesish.
- 13) Dergon informacione te ndryshme per probleme te lagjes tek administratori jo me pak se nje here ne tre muaj.
- 14) Merr pjese ne zgjidhjen e konflikteve te banoreve per ceshtje te ndryshme prone, civile familjare etj.
- 15) Kontrollon dhe pergjigjet per kontrollin e territorit te lagjes.
- 16) Kujdeset per respektimin e harmonise fetare ne lagje.
- 17) Urdherat, udhezimet, vendimet e organeve te zgjedhura te bashkise jane te detyshueshme per zbatim.
- 18) Ndhmon dhe bashkepunon me administratorin e lagjes dhe specialistet e saj per regjistrime te ndryshme statistikore, censuse, pyetsor e te dhena te tjera ne lagje sipas akteve ligjore e nenligjore.
- 19) Kujdeset per problemet e rendit dhe qetesis publike ne lagje duke bashkepunuar me inspektoret e policise rendit dhe policine bashkiake.

Neni 22

Perdorimi i vules

Nderlidhesi komunitar mund te pajise me vule zyrtare nga bashkia dhe mban pergjegjisi per perdorimin e vules sipas akteve ligjore e nenligjore.

Vula zyrtare perdoret vetem per dokumenta qe kane nr. protokolli, date dhe jane te firmosura nga nderlidhesi komunitar.

Ne raste e humbjes se vules njoftohet menjehere bashkia dhe komisariati i policise dhe merren masa per zevendesimin e saj sipas procedurave ligjore.

Neni 23

Dokumentacioni qe mban nderlidhesi komunitar

Llojet e dokumentacionit qe leshon dhe firmos nderlidhesi komunitar jane:

1. Vertetim qe eshte banor i lagjes.
2. Vertetim qe therritesh me dy emra.
3. Vertetim qe ka mbjelle kultura dru frutore per efekte te perjashtimit nga taksa.
4. Vertetim qe e perdor token bujqesore.
5. Vertetim qe ka prodhuar dru zjarri nga krasitjet e pemeve frutore.
6. Vertetime te tjera per fakte e te dhena per banoret e lagjes, per te cilat ai eshte ne dijeni, sa here qe kjo kerkohet nga bashkia, nga vete banoret ose nga cdo institucion tjeter ne perputhje me ligjin

7. Nderlidhesi merr pjese ne grupet e punes te ngritura nga administratori i lagjes:

-Ne perplimin e proces verbaleve per demtimet nga termeti, permbytjet, zjarri, rreshqitje e fatkeqesi te tjera natyrore.

- Ne hartimin e proces verbaleve per mbjelljet e reja te kulturave dru frutore.

-Ne procesverbale te tjera konstatimesh.

Nderlidhesi komunitar mban dhe perditeson edhe keto dokumenta te tjere:

- a) proces verbalet e kufijve te lagjes dhe kopjen e hartes.
 - b) kopjen e dokumentacionit te zgjedhjeve te keshillit komunitar dhe te nderlidhesit.
 - c) Liber protokolli per mbledhjet e kuvendit qytetar dhe te keshillit komunitar.
 - d) kopje vendimesh e propozime te keshillit komunitar.
 - e) Vendimet, urdheresa e urdhera te keshillit bashkiak dhe te kryetarit te bashkise qe rregullojne funksionimin e punes te nderlidhesit.
 - f) Rregulloren e brendshme "Per strukturat komunitare ne qytet"
 - h) Listen e lajmerimit te skuadres te M.K.Z. te lagjes.
 - i) Mban te dhena statistikore per lagjen
- Nr. e popullsise, te familjeve dhe te treguesve demografike.
- Nr e familjeve ne nd. ekonomike, nr e te paafteve , te verbereve, te tetra e para plegjikeve, te familjeve shume te varfera etj.
- Nr e biznesve ne lagje etj

Neni 24

Ndërlidhësi komunitar

Ndërlidhësi komunitar përfaqëson komunitetin dhe ka kompetencë të:

- a) Thërrasë dhe drejtojë mbledhjen e kuvendit qytetar dhe këshillit komunitar;
- b) Nënshkruaj aktet e kuvendit qytetar dhe këshillit komunitar;
- c) Përfaqëson strukturat komunitare në qytet në institucionet publike;

d) Kryen çdo detyrë tjetër të përcaktuar nga kuvendi qytetar, këshilli komunitar, këshilli dhe kryetari i bashkisë.

Ndërlidhësi Komunitar mund të thirret në mbledhjet e këshillit bashkiak për të shprehur mendimin e tij për çështje që janë të lidhura me komunitetin sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e këshillit të bashkisë.

Ndërlidhësi komunitar shpërblehet për punën që kryen në masën dhe sipas kriterëve të përcaktuara nga këshilli bashkiak.

Neni 25

Burimet financiare

Në themel të organizimit komunitar qëndron parimi i vullnetarizmit për vetëorganizim e vetëkontribut si dhe filantropia dhe humanizmi qytetar. Strukturat komunitare me qëllim përmbushjen e misionit, kompetencave dhe detyrave të tyre mund të mobilizojnë fonde nga:

- a) vetëkontributet e qytetarëve;
- b) transfertat nga buxheti i bashkisë;
- c) financimet dhe donacionet prej personave fizik dhe juridik;
- d) grantet dhe financimet prej projekteve të huaja etj.

Këshilli i bashkisë miraton rregulloren për mobilizimin dhe përdorimin e burimeve financiare nga ana e strukturave komunitare.

KREU IV

MARRËDHËNIET ME BASHKINË DHE STRUKTURAT E SAJ

Neni 26

Marredheniet e strukturave komunitare

Strukturat komunitare në qytet, për çështjet dhe veprimtarinë e tyre komunitare, gëzojnë autonominë dhe lirinë e duhur për të realizuar me sukses misionin dhe përgjegjësinë e tyre.

Marrëdhëniet dhe raportet me këshillin / kryetarin e bashkisë dhe institucionet e tjera janë marrëdhënie bashkëpunuese në dobi të njohjes, prezantimit dhe zgjidhjes së problemeve të komunitetit. Këshilli dhe kryetari i bashkisë mund të delegoj kompetenca nga kompetencat e veta strukturave komunitare në qytet. Delegimi i kompetencave duhet të shoqërohet kurdoherë me rregulla, standarde dhe burime të mjaftueshme financiare.

Struktura komunitare gëzon të drejtën e bashkëpunimit dhe të drejtën e krijimit të organizmave bashkëpunuese në interes dhe dobi të komunitetit me njësitë e tjera komunitare, me organizata dhe rrjete të shoqërisë civile, me grupet e interesit, me forumet intelektuale, rinore, qytetare etj.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE

Proçesi i ngritjes së strukturave komunitare në qytetin e Elbasanit do të bëhet brenda 2 muajve nga miratimi i kësaj rregulloreje.

Për herët e tjera, zgjedhja e strukturave komunitare në qytet do të behet duke zbatuar afatet e përcaktuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

B. Struktura komunitare ne fshat (Bashkia ka 116 fshatra)

Fshati drejtohet nga kryetari dhe kryesia e fshatit. (zgjedhjet behen 1 here ne kater vjet).

Detyrat dhe kompetencat ne fshat percaktohen nga rregullorja e miratur ne keshillin bashkiak, “Per organizimin dhe funksionimin e strukturave komunitare ne fshat te bashkise Elbasan”

RREGULLORE

“Për organizimin dhe funksionimin e strukturave komunitare në fshat, të bashkisë Elbasan.

(Kryetar/kryesi fshati)

Kreu I

Kjo rregullore mbështetet në ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar neni 8/2,9/1/1/54k,70,71 ,ligji Nr .44/2015 dt.30.04.2015 “Kodi I Proçeduarve të Republikës së Shqipërisë” të ligjit 115/2014 dt.31.07.2014 “Për ndarjen admisnitrativo territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren e këshillit bashkiak “Për funksionimin e administratës” dhe ka si qëllim që të rregullojë sa më mirë funksionimin e kryesisë dhe kryetarit të fshatit për ti njohur me detyrat kompetencat dhe të drejtat e tyre për një funksionim të mirë të qeverisjes në fshat dhe për një bashkëpunim më të mirë me bashkinë për përmirësimin e shërbimit ndaj komunitetit në fshat.

Neni

Nëndarja e njësisë administrative (fshati)

- a. Fshati është pjesë e Njësisë Administrative përkatëse të bashkisë. Numri i strukturave komunitare (nën ndarjeve administrative)paraqiten në listën nr.1 qe i bashkangjitet si pjese përbërëse e kësaj rregullore
 - b. Shtrirja territoriale, kufijtë dhe emri i fshatit përcaktohet me ligj.
 - c. Fshati i ri krijohet me propozim të Këshillit Bashkiak dhe miratohet me ligj.
 - d. Kufijtë ndarës administrativo-territoriale të fshatit dhe hartën e përditsuar e miraton këshilli bashkiak sipas standarteve të përcaktuara gjeohapësinore.
 - e. Fshati përbëhet nga lagjet dhe numri i tyre peër çdo fshat miratohet nga këshilli bashkisë. Numri i lagjeve paraqitet në listën numër 2 që i bashkangjitet kësaj rregullore.
- Lagja ka vijueshmëri gjeografike dhe territoriale.
- 1.Fshatrat deri në 500 banorë përbëhen nga 3 lagje.
 - 2.Fshatrat nga 501-1500 banorë përbëhen nga 5 lagje.
 - 3.Fshatrat mbi 1500 banore perbehen nga 7 lagje.

Neni 2

Struktura komunitare në fshat

- 1.Fshati drejtohet nga kryesia e fshatit dhe kryetari i fshatit. Kryesia është organ këshillimor i kryetarit të fshatit.

Neni 3

Organizimi dhe procesi i zgjedhjes së trukturave komunitare

Adminitratorët e njësive administrative marrin të gjitha masat për organizimin e proçedurave për zgjedhjen e strukturave komunitare (kryesi dhe kryetar). Këshilli bashkiak ndjek proçedurat për zgjedhjen e strukturave komunitare.

Njësia administrative në bashkupnim me kryetarin e fshatit informon të gjithë shtetasit të cilët kanë të drejtë vote për organizimin e procedurave të zgjedhjeve të strukturave administrative. Me anë të njoftimeve publike, i cili përmban datën, orën si dhe vendin e organizimit të mbledhjes.

Neni 4 **Zgjedhja e kryesisë së fshatit**

Anëtarët e kryesisë së fshatit zgjidhen në mbledhjen e fshatit me shumicën e votave të pjesëmarrësve me të drejtë vote në mbledhje.

Përbërja e kryesisë fshatit duhet të respektojë ligjin për barazinë gjinore.

Në raste ku fshati përbëhet nga disa lagje, secila lagje zgjedh një anëtar kryesie.

Mënyrat dhe rregullat e votimit përcaktohen nga këshilli bashkiak.

2. Numri i anëtarëve të kryesisë fshatit përcaktohen nga këshilli bashkiak mbi bazën e numrit të banorëve të fshatit dhe lagjeve përbërës të tij. Në mbledhjen e organizuar për zgjedhjen e kryesisë paraqiten dhe bëhet një prezantim i shkurtër i kandidatëve:

a) Zgjidhet një komision votimi si rregull 3 anëtarë nga përfaqesues të komunitetit të fshatit.

b) Komisioni i votimit drejton të gjithë procedurat, plotëson fletë votimet dhe përcakton rregullat e votimit.

c) Votimi për anëtarë kryesie bëhet i hapur ose i fshehtë

Zgjedhja e kryesisë së fshatit bëhet një herë në 4 vjet pas zgjedhjeve të këshillit bashkiak dhe jo më vonë se 3 muaj pas këtyre zgjedhjeve.

Neni 5 **Kryetari i fshatit**

Kryetari i fshatit zgjidhet nga radhët e kryesisë së fshatit me votim të fshehtë me jo më pak se (2) kandidatura.

1) Zgjedhja e kryetarit të fshatit bëhet një herë në katër vjet pas zgjedhjeve për këshillin bashkiak dhe jo më vonë se tre muaj pas këtyre zgjedhjeve.

2) Në rast mosrespektimi këtij afati, deri në zgjedhjen e kryesisë fshatit, kryetari i bashkisë emëron përkohësisht kryetarin e fshatit.

3) Proçesi zgjedhës së kryetarit të fshatit organizohet nga njësia administrative sipas rregullave të miratuara nga këshilli bashkiak.

a) Në mbledhjen e organizuar për zgjedhjen e kryetarit të fshatit fillimisht paraqitet dhe bëhet një prezantim i shkurtër i kandidatit të propozuar.

b) Zgjidhet një komision votimi si rregull me 3 anëtarë nga komuniteti

c) Komisioni i votimit drejton të gjitha procedurat deri në shpalljen e kryetarit, plotëson fletë votimet dhe përcakton rregullat e votimit

d) Votimi bëhet i fshehtë dhe pas votimit hartohet proçes –verbali nga komisioni dhe proçes –verbali firmoset edhe nga anëtarët e kryesisë, i deleguari i këshillit bashkiak dhe i njësies administrative dhe më pas shpallet kryetari i zgjedhur.

Neni 6
Përfundimi i mandatit të anëtarit të kryesisë dhe kryetarit të fshatit

1- Mandati i anëtarit të kryesisë dhe kryetarit të fshatit përfundon para afatit në rastet kur:

- a) Jep dorëheqjen
- b) Nuk është banorë i përhershëm i fshatit tij.
- c) Humbet zotesinë juridike me vendim gjykate të formës së prerë
- d) Shkarkohet nga detyra kur bën shkelje ligjore dhe nuk kryen detyrat e ngarkuara me ligj.

2- Anëtari dhe kryetari i kryesisë në rastet e dorëheqjes e depoziton kërkesën pranë njësisë administrative:

- a) Për ndjekjen e procedurave administratori i njësisë administrative brënda 3 ditëve njofton kryetarin e bashkisë për aktin e dorëheqjes
- b) Me përfundimin para kohe të mandatit të kryetarit të fshatit deri në zgjedhjen e kryetarit të ri funksionet i kryen një anëtarë i kryesisë së fshatit i propozuar ngakryesia e fshatit.
- c) Në rast kur qytetarët e konsiderojnë qe kryetari ose anëtarët e kryesisë së fshatit nuk i kanë përmbushur detyrimet ligjore ato mund të shkarkohen me shumicën e votave të banorëve të fshatit.
- d) Kjo procedurë do të zbatohet në rastin e paraqitjes e një nocioni mos – besimi i cili do të përmbajë nënshkrimet e më shumë së gjysmës së numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur kryesia e fshatit.
- e) Kryetari i fshatit mund të largohet nga detyra kur anëtarë t e kryesisë paraqesin nocion mos-besimi ndaj tij dhe në këtë rast vazhdon procedura e zgjedhjes së kryetarit të ri.
- e) Kryetari i fshatit ne çdo rast që largohet nga detyra duhet të dorëzojë vulën dhe dokumentacionin tek administratori i njësisë administrative
- f) Në rastet e krijimit të vendit vakant për kryetarin e fshatit ose për anëtarët e kryesisë zhvillohen procedurat e mësipërme të zgjedhjes për vendin vakant sipas Nenit 4 dhe 5 të kësaj rregullorje.

Mandati i të zgjedhurve të ri vazhdon deri në përfundimin e periudhës mbetur të afatit katër vjeçar.

Kreu II

Neni 7
Roli dhe përgjegjësitë

Kryetari dhe anëtarët e kryesisë së fshatit kanë përgjegjësi për të vepruar dhe punuar në bazë të parimeve të profesionalizimit, paanësisë politike, transparencës, ligjit dhe korrektësisë në zbatimin e detyrave.

- a) Kryetari i fshatit nënshkruan të gjithë aktet e kryesisë së fshatit si dhe proces – verbalet të mbledhjes së kryesisë
 - b) Kryetari i fshatit siguron zbatimin e vendimeve të kryesisë së fshatit të këshillit bashkiak dhe të akteve administrative të kryetarit të bashkisë.
- Kryesia e fshatit mbledhet të paktën një herë në dy muaj.
Proces verbalet e mbledhjeve të kryesisë nënshkruhen nga mbajtësi i tij dhe kryetari i fshatit.

Neni 8
Detyrat dhe të drejtat e kryetarit e të kryesisë fshatit

1. Kryetari dhe kryesia e fshatit kryejnë dhe mbështesin funksionet vetëqeverisëse të bashkisë në fshatin e tyre, si dhe kujdesen për zhvillimin ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale.
2. Bazuar në vendimin e kryetarit të bashkisë, kryetari dhe kryesia e fshatit kryen edhe këto detyra:
 - a) kujdeset për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve të ujrave të bardha dhe ujërave të ndotura, të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara, si dhe të rrjetit të kanaleve tretësore të ujitjes dhe kullimit;
 - b) kujdeset për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme dhe të çdo lloj dëmtimi të rrugëve, trotuareve, ndricimit lulishteve dhe shesheve publike në fshat;
 - c) Kujdeset për administrimin e varrezave të fshatit.
 - d) Kujdeset për ruajtjen e pyjeve, kullotave si dhe të burimeve natyrore.
 - dh) Kujdeset për ruajtjen e ambientit, grumbullimin dhe largimin e mbeturinave.
 - t) kujdeset për mbarëvajtjen e ujitjes tokave në fshat.
 - th) Kujdeset për furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike në fshat.
3. Kontrollon dhe njofton organet e bashkisë dhe policisë për kultivimin e bimëve narkotike në fshat.
4. Merr pjesë në grupet e punës për verifikime të ndryshme në fshat dhe grumbullim të dhënash me punonjësit e njësisë administrative dhe të bashkisë.
5. Bën njoftime të ndryshme për banorët e fshatit për problem pune si;
 - Njofton banorët për mobilizime të ndryshme për raste të emergjencave civile si fatkeqësish natyrore për ndihmë e kontribute dhe evakuime të ndryshme sipas rasteve.
 - Shpërndan njoftimet tatimore për taksat familjare në fshat.
 - Njofton banorët për punë të ndryshme në komunitetin e fshatit.
 - Njofton banorët për aktivitete të ndryshme në fshat.
 - Njofton banorët për mbledhje të fshatit etj.
6. Kryetari i fshatit jep mendime për prioritet e investimeve dhe shërbimeve në fshat.
7. Kujdeset për mbarëvajtjen e arsimit dhe shëndetësisë në fshat.
8. Kujdeset për ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore dhe historike në fshat, të monumenteve të kulturës, të natyrës të lapidarëve dhe vepra të artit etj
9. Kujdeset për organizimin e veprimtarive të ndryshme sportive, kulturore, artistike etj në fshat.
10. Bën vendosjen dhe afishimin për publikim pranë qendrave të votimit në fshat të listave të zgjedhjeve paraprake dhe përfundimtare të votimit.
11. Bashkëpunon me shoqata të ndryshme që operojnë në territorin e fshatit.
12. Bashkëpunon në hartimin e listave dhe shpërndarjen e ndihmave të ndryshme humanitare në raste fatkeqësish.
13. Dërgon informacione të ndryshme për probleme të fshatit në bashki e njësinë administrative jo më pak se njëherë në tre muaj dhe sa herë që kërkohet nga bashkia.
14. Zgjidh konfliktet e banorëve për çështje të ndryshme prone, civile, familjare etj.
15. Kontrollon dhe përgjigjet për kontrollin e territorit të fshatit.
16. Njofton në kohë bashkinë për rastet e emergjencave civile në fshat si përmytje, zjarre, tërmete, rrëshqitje toke dhe fatkeqësi të ndryshme natyrore dhe ndërhyrjen e mobilizon komunitetin për ndihmë.
17. Kujdeset për respektimin e harmonisë fetare në fshat.
18. Urdhëresat, vendimet dhe urdhërat e organeve të zgjedhura të bashkisë janë të detyrueshme për zbatim nga kryetari dhe kryesia e fshatit.
19. Merr pjesë në mbledhjet e këshillit të prindërve në shkollë dhe njihet me problemet e arsimit në fshat.
20. Ndihmon dhe bashkëpunon me specialistët e njësisë, administrative dhe të bashkisë për regjistrime të ndryshme statistikore në fshat, censuse, pyetsore, të dhëna të ndryshme

sipas akteve ligjore e nënligjore e etj.

21.Harton në bashkëpunim me Agjencinë e pyjeve, bujqësisë, veterinarisë dhe mjedisit listën e nevojave vjetore për dru zjarri për nevoja familjare.

22.Ndjek zbatimin e orareve të lokaleve në fshat në oret e vona të natës sipas urdhëresës së këshillit bashkiak.

23.Kujdeset për problemet e rendit dhe të qetësisë publike në fshat duke bashkëpunuar me inspektorët e policisë rendit dhe policinë bashkiake.

Neni 9

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor

1.Kryetari i fshatit mund të thirret në mbledhjet e këshillit bashkiak ose merr pjesë në to me nismen e tij pa të drejtë vote.

2.Ai ka të drejtë të shprehë mendimin e tij në mbledhje për çështje që janë të lidhura me fshatin e tij.

Neni 10

Aktet Administrative

Aktet administrative vendime urdhëra shkresa janë ato akte që nxirren në ushtrim të funksioneve kompetencave dhe që kanë fuqi brënda juridiksionit territorial të fshatit.

a) Cdo akt i miratuar nga kryetari dhe kryesia e fshatit duhet të përmbajë arsyetimin për nxjerrjen e aktit shpjegimin e kuptimit të aktit bazueshmërine ligjore personit, institucionit ose organizatës të cilës i drejtohet, personat apo strukturat e ngarkuara për zbatimin e aktit në momentin e hyrjes në fuqi të aktit

b) Urdhëresat, vendimet dhe urdhërat e organeve të zgjedhura të bashkisë janë të detyrueshme për zbatim nga kryetarët dhe kryesia e fshatit.

Neni 11

Përdorimi i vulës

Kryetari i fshatit pajiset me vulë zyrtare nga bashkia e cila e identifikon me aktet administrative të nxjerra prej tij.

Kryetari i fshatit mban përgjegjësi për përdorimin e vulës sipas akteve ligjore e nën ligjore.

Vula zyrtare përdoret vetëm për dokumente që kanë datë numër protokolli dhe janë të firmosura nga kryetari i fshatit.

Në rastet e humbjes së vulës njoftohet menjëherë bashkia dhe komisariati i policisë si dhe meren të gjitha masat për zëvendisimin e sajë sipas proceduareve ligjore.

Neni 12

Llojet e dokumentacionit që lëshon dhe firmos kryetari i fshatit

Kryetari i fshatit pajiset me vulë dhe ka autoritetin të lëshojë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose territorin e fshatit të tij, për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kërkohet nga bashkia, nga vetë banorët ose nga cdo institucion tjetër, në përputhje me ligjin si;

1.Vërtetim që është banor i fshatit.

2.Vërtetim që thërritet me dy emra në fshat.

3.Vërtetim që ka mbjellë kultura bujqësore, dru frutore dhe prodhimet e tyre.

4.Vërtetim që përdor tokën bujqësore.

5.Vërtetime për sjellje e qëndrim shoqërorë në fshat për banorët dhe familjet e fshatit.

6.Vërtetim qe ka prodhuar dru zjarri për nevojat e tij nga krasitje dhe prerja e kulturave dru frutore.

Kryetari perpilon dhe firmos edhe këto proçesverbale në bashkëpunim me grupet e punës të bashkisë.

- 1.Proçesverbal për demtime në fshat nga tërmeti, përmytjet, zjarret, rrëshqitjet e fatkeqësi të tjera natyrore etj.
- 2.Proçesverbale të mbjelljeve të reja të kulturave drufrutore për efekte të përjashtimit të taksës të tokës.
- 3.Proçes verbale të saktësimit të sipërfaqeve të ndërtesës dhe të truallit kur mungon regjistrimi nga Z.V.R.P.P.
- 4.Proçes verbale të tjera konstatimesh.

Neni 13

Dokumentacioni i kryetarit te fshatit

1.Kryetari fshatit krijon dhe mban dokumentacionin për të gjithë aktivitetin e tij dhe të kryesisë fshatit si më poshtë:

- 1.Proçes verbalet e kufijve e të shtrirjes së fshatit dhe hartën e fshatit.
- 2.Dokumentacionin e zgjedhjes së kryetarit dhe kryesisë fshatit.
- 3.Libër protokollit për mbledhjet e kryesisë fshatit.
- 4.Vendimet e marra dhe propozimet rekomanduara nga kryesia e fshatit dhe kryetari fshatit.
- 5.Vendimet e kryetarit të bashkisë të këshillit bashkiak në lidhje me fshatin e tij.
- 6.Rregulloren e brëndshme të këshillit bashkiak për funksionimin dhe detyrat e kryetarëve dhe të kryesive të fshatrave, në Njësitë Administrative të bashkisë Elbasan.
- 7.Urdhërat dhe urdhëresat e këshillit bashkiak në lidhje me fshatin.
- 8.Proçes verbalin e vulës zyrtare, përdorimin dhe ruajtjen e saj sipas akteve ligjore.
- 9.Korespondenca me njësinë administrative, bashkinë dhe institucione të tjera shtetërore.
- 10.Listen e lajmerimit dhe te skuadres e M.K.Z. te fshatit
- 11.Mban te dhëna statistikore për fshatin si:
 - a).Nr. i popullsisë, i familjeve dhe treguesve të tjerë demografike
 - b) Sipërfaqja e përgjithshme e fshatit dhe e ndarë në tokë pyll, kullotë, livadhe, toka të abandonuara, sipërfaqja ujore dhe toka arë e nga kjo sa është e ndarë dhe sa është pandarë.
 - c) Kulturat e mbjella në fshat sipërfaqja dhe prodhimi.
 - d) Nr. i krerëve të bakëtime për të gjithë llojet dhe prodhimi.
 - dh) Numri i vetëpunësuarve në fermen private, në shtet dhe aktivitet privat.
 - m) Numri i automjeteve sipas llojeve dhe mjeteve bujqesorë.
 - n) Numri i familjeve me nd. ekonomike, nr. i të paaftëve, invalidëve, të verbërve, i paraplegjikeve dhe i tetraplegjikeve, numri i familjeve të varfëra e në nevojë.
 - r) Numri i bizneseve në fshat etj.

Kryetari i fshatit në fund të çdo viti në bazë të rregjistrimit të korespondencës bën dorëzimin e dokumentacionit shkresorë origjinal (të krijuar /të ardhur) në njësinë administrative.

Neni 14

Shpërblimi i kryetarit të fshatit

Kryetari i fshatit shpërblehet për punën që kryen, sipas kritereve të percaktuara nga këshilli bashkiak në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 15

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga këshilli bashkiak.

Emrat e kryetareve te fshatrave, te ndara sipas Njesive Administrative:**Njësia Administrative Bradashesh**

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
1	Gani	Zavalina	Bradashesh	692331317
2	Arian	Gjoni	Balez-Lart	688180574
3	Ferit	Ruçi	Kusarth	692962565
4	Jonuz	Hasa	Letan	683132848
5	Kujtim	Gjika	Rrile	684273323
6	Arian	Kalashi	Ulem	685934558
7	Jashar	Muça	Katund i Ri	686921142
8	Stavri	Terziu	Fikas	695611552
9	Selim	Kasa	Petresh	693959274
10	Selami	Islami	Shemhill	684511989
11	Shefqet	Hasfatija	Recan	694722379
12	Jonuz	Shorja	Gurabardhe	682244579
13	Sotir	Terziu	Shijon	695287133
14	Hysni	Bradasheshi	Kozan	685979711
15	Bashkim	Hasa	Shtemaj	682285738
16			Balez-Poshte	
17			Karakullak	

Njësia Administrative Shushicë

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
18	Nazmi	Boja	Polis-Vogel	686458821
19	Gjergji	Pisha	Hajdaran	697763484
20	Erisjon	Zheli	Shushice	693960328
21	Bujar	Bozhiqi	Vreshtan	683765355
22	Arjan	Sollaku	Mlize	686329540
23	Marku	Bodurri	Shelcan	684955660
24	Qani	Cekani	Polis-Vale	685737685
25	Hajrulla	Tanushi	Fush-Bull	683658576
26	Ismail	Tanushi	Vasjan	683814957

Njësia Administrative Shirgjan

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
27	Mimoza	Çakalli	Bathës	682303857
28	Ligor	Dedja	Kryezjarth	684068109
29	Kozma	Sulanjaku	Kuqan	682229985
30	Osman	Sula	Jagodinë	682672632
31	Ylli	Buzani	Bujgjës	676971839
32	Ramadan	Roçi	Mjekës	676026286
33	Gezim	Murati	Shirgjan	682984743

Njësia Administrative Papër

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
34	Gazmir	Kulla	Paper	682145052
35	Asqeri	Dyrma	Lugaj	682296879
36	Dylaver	Cani	Valas	682401282
37	Ervist	Rama	Balldre	692379705
38	Pellumb	Baho	Broshke	695171504
39	Riza	Çela	Murras	692385911

40	Kadri	Subashi	Pajun	683235221
41	Petrit	Myqelesi	Bizhute	686481926
42	Hysen	Kasa	Jatesh	683314632
43	Ibrahim	Hasalla	Paper Sollak	685934514
44	Ferdinant	Sheganaku	Vidhas	685782162
45	Riza	Salla	Vidhas-Hasgjel	683077970
46	Daut	Kodralliu	Ullishtaj	682689248

Njësia Administrative Gjergjan

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
47	Arta	Preca	K/Bujaras	688188478
48	Shkelqim	Kishta	Bujaras	686194561
49	Gezim	Sollaku	Keshtjelle	685326919
50	Gezim	Tata	Gjergjan	685471067
51	Selim	Kumria	Gjonme	686533444
52	Hajdar	Zyba	Muriqan	682619530
53	Bujar	Duzha	Thane	685293534

Njësia Administrative Labinot-Fushë

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
54	Agron	Zejneli	Mengel	693951071
55	Agim	Balliu	Labinot-Fushe	696379476
56	Bashkim	Murtina	Xibrake	699376121
57	Kapllan	Salla	Godolesh	686357261
58	Agim	Toca	Griqan-Siper	692978713
59	Agim	Murati	Griqan-Poshte	676343551

Njësia Administrative Labinot-Mal

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
60	Sulejman	Bahushi	Labinot-Mal	682505044
61	Kujtim	Laloshi	Lugaxhi	688062419
62	Mustafa	Zhabina	Lamolle	683695346
63	Xhafer	Duraku	Benë	686275698
64	Dashamir	Bica	Qafë	682364411
65	Shkëlqim	Karagjozi	Qarret	682966624
66	Agim	Sula	Shmil	683645942
67	Hyqmet	Leci	Sericë	692805895
68	Rexhep	Ruçi	Dritas	683403388
69	Xhemal	Rranci	Guri Zi	684668786

Njësia Administrative Gjinar

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
70	Afrim	Pepa	Pobrat	682318964
71	Reshit	Myrta	Lleshan	692240605
72	Emanuel	Hida	Lukan	682216841
73	Ferdinand	Derstila	Derstile	694384758
74	Kostandin	Mufali	Gjinar	695863334
75	Nikolla	Qosja	Maskarth	692237714
76	Dhimiter	Muca	Pashtresh	683139281
77	Arti	Karaj	Xibresh	685184368
78	Merkur	Toci	Valesh	682932316
79	Vangjel	Panxhi	Kaferr	692373628
80	Naun	Bodurri	Sterstan	682451682

Njësia Administrative Tregan

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
81	Bujar	Bajrami	Tregan	682549030
82	Behar	Kyçyku	Kyçyk	682506006
83	Preni	Bërdufi	Trepshishte	693858825
84	Beqir	Papri	Muçan	683480378
85	Musa	Jolla	Shilbater	686410118
86	Endri	Tashi	Çikallesh	685398484
87	Gezim	Muca	Tudan	673801422
88	Bledar	Lici	Gurisht	688452150
89	Bajram	Debrova	Blerimas	684449392
90	Ali	Toromani	Shinavllash	682195968
91	Petrit	Karaj	Kacivel	682249903
92	Gjini	Cakalli	Bizhdan	682307576

Njësia Administrative Funar

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
93	Astrit	Shengjergji	Bixelle	684011090
94	Gazment	Likrama	Branesh	685918248
95	Refat	Ceka	Prece e Poshme	684013540
96	Gani	Likrama	Prece e Siperme	682730865
97	Tahir	Haka	Ceruje	688378655
98	Sabri	Disha	Korre	694896333
99	Hysen	Sinani	Mollagjes	684013523
100	Fadil	Stafa	Stafej	683225068
101	Refik	Dulla	Krrabe e Vogel	684827009

Njësia Administrative Gracen

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
102	Kujtim	Balla	Gjormë	683023981
103	Luan	Dopi	Dopaj	697407090
104	Abdulla	Qosja	Shingjin	682507047
105	Hazis	Çeka	Gracen	695120191
106	Shyqyri	Sefdari	Pajengë	692191874
107	Robert	Hasa	Bodin	684568642
108	Fatos	Gjata	Tërbaç	693553163
109	Ndriçim	Kasa	Plangaricë	682980831
110	Ismail	Llapa	Mamël	686965185

Njësia Administrative Zavalinë

Nr.	Emër	Mbiemër	Fshati	Kontakti
111	Kostandin	Bica	Seltë	682388293
112	Tomorr	Sinani	Burrishtë	692677397
113	Shkelqim	Khaka	Kamiçan	685351182
114	Spiro	Dedja	Jeronisht	683251718
115	Mihal	Skenderi	Zavalinë	682357580
116	Staver	Bezhani	Nezhan	683298435